

KOLEC TOPALLI

NGA VEPRA FJALOR ETIMOLOGJIK I GJUHËS SHQIPE VI

O

orték m. “rruzull i madh bore, që rrokulliset nga malet e larta dhe merr me vete ç’gjen përpara”. Fjalë e dialektit gegë, që shumësin e bën *ortiqe*. Në epikën legjendare: *Ushtojnë lugjet prej ortiqesh; prej ortiqesh kah po bijnë ndër gropa*. Formim i brendshëm nga emrin *rrotë*, që ka marrë një *o-* si parashtesë ose si zanore mbështetëse, që krijon rrokje. Ka marrë gjithashtu prapashtesën *-ak*, që me metafoninë e shumësit bën *-ek*. Pas rënies së zanores së patheksuar, bashkëtingëllorja *-rr-* është kthyer në *-r-* duke u ndodhur në një grup bashkëtingëllor (khs. *arsye* nga *arr(ë)sye*, lat. *ratiōnem*); balli i fjalës është zhvilluar si tek emri *ortundë* “vorbë e madhe pa veshë” nga lat. *rotundum* dhe ndërrimi *-a- > -e- > -i-* (**ortak : ortek : ortiqe*) ka ndjekur modelin e shumësave *lak : leqe : liqe, konak : koneqe : koniqe*.

oshënar m. “murg ose besimtar ortodoks, që rron i vetmuar e me mundime trupore për të fituar hirin e zotit”. Fjalë e dialektit toskë, e komunitetit fetar ortodoks, me burim të paqartë. Mund të jetë formim i brendshëm me parashtesën *o-*, nga rrënja *shën*, shkurtim i emrit *shenjt* (khs. *Shën Vasili*), që ka marrë prapashtesën *-ar*. Rrjedhoja *oshënarí* ka marrë prapashtesën *-í*.

oshëtín fol. “ushton”. Fjalë kryesisht e dialektit toskë, për të cilën gegërishtja ka *ushton*. Është krijim i brendshëm nga një bazë onomatopeike *osh*, që ka marrë prapashtesën *-(ë)t* duke u integruar në paradigmen e foljeve me *-inj ~ -in* (khs. *vetëtin, shkrepëtin*). Rrjedhoja *oshëtímë* ka marrë prapashtesën *-më*.

P

palmúc ndf. “me trup të mbledhur; lëmsh, shuk”. Fjalë e gegërishtes veriore. Formim i brendshëm nga *palë + muq*, elementi i dytë me burim nga it. *mucchio* “grumbull”. Qiellzorja *-q-* është kthyer në afrikate, dukuri e të folmeve ku gjendet fjala. Lidhet përbrenda gjuhës me *lëmuq* “shuk, njëri mbi tjetrin”, që del edhe me formën *lëmuç*, me të njëjtin zhvillim fonetik. (Luka III 276).

papërdhók m. “guralec; kokërdhok”. Fjalë e dialektit gegë, kryesisht e gegërishtes veriore. Formim i brendshëm nga *kokërdhok* me disimilim të dy grykoreve në një fjalë ku ka tri të tilla. Për një dukuri të tillë khs. *kapërcej* nga *ka + kërcej*, *kapërcyell* nga *ka + kërçyell*. (Camaj Wort. 111, Luka III 279).

parmendë f. “vegël bujqësore prej druri, që përbëhet nga përdheci me plor”. Fjalë e mbarë gjuhës. Format dialektore dëshmojnë se trajta më e hershme e fjalës ka qenë *parëmendë*. Huazim nga lat. *armamentum*, e cila me kuptimin “vegël, mjet” është përdorur jo vetëm në fushën luftarake, por edhe në fusha të tjera duke u specializuar për fushën e bujqësisë në gjuhën shqipe. Ka marrë parashtesën *për-* duke u thjeshtuar forma **përarmamentum* në *parmendë* me anë të haplogjisë (disimilim rrokjesor). (Meyer EW 322, Jokl IF 36, 1915, 155, Haarmann Lat. Lehn. 100, Ölberg IWA 31, Orel AED 311, Topalli SF 2, 1988, 157, Çabej SE VI 143).

páshtër f. “livadh i pakullotur”. Fjalë krahinore e vjetruar. Huazim nga lat. *pastūra*, një nga huazimet e moçme nga ajo gjuhë, çka e dëshmon rrëgjimi i zanores së patheksuar dhe sidomos zhvendosja e theksit në rrokjen nistore, që i përket një periudhe të hershme, kur shqipja kishte një theks të tillë.

pavdirë (i) mb. “që s’shuhet, që s’humbet”. Fjalë krahinore e dialektit gegë. Formim i brendshëm nga folja *vdjerr* “humb”, vetë kjo nga *bjerr* me të njëjtin kuptim. Mbiemri *i pavdirë* mbështetet në formën joveprore me ndërrimin *-e- > -i-* të sistemit foljor. Prej kuptimit *vdjerr* “humb” me parashtesën *pa-* fjala ka marrë kuptim të kundërt “që s’humbet”.

pëqí m. “pjesa e përparme në fund të një veshjeje të sipërme, këndi i palltos”. Fjalë e mbarë gjuhës, që nuk e kanë ngulimet jashtë Shqipërisë. Gegërishtja e ka me trajtat *spëlqí*, *shpëlqí*. Dëshmohet së pari te Budi: *tue i puthunë dorënë ò spëngjinë e petëkut*. Për burimin e fjalës, krahasimi i formave të ndryshme nxjerr në dritë rrënjën **qin-* nga **klin-*, që është marrë nga lat. *clino* “përkul”. Pjesa tjetër përbëhet nga parashtesa dhe tinguj të shtuar. (Camarda I 130, Meyer EW 331, Orel AED 319, Çabej SE VI 188).

përbinjóre f. “dele ose dhi që pjell për herë të dytë”. Fjalë me përhapje dialektore. Formim i brendshëm nga *për-* + *binjore*, ku gjymtyra e fundit lidhet përbrenda gjuhës me *binjak*, *binjok*, *binjarak*, *binjosh* dhe *binak*, *binok*, *binosh*, *bineq* etj., të gjitha formime me prapashtesa të ndryshme nga një rrënjë **bin-* ~ **binj-* me kuptimin e numrit “dy”, me burim nga lat. *bini* “dy nga dy”. Nga ana e formimit lidhet sidomos me *binjuer* ~ *binjori* “degë furke, bigë”; kurse nga ana kuptimore lidhet me *përbiçkë* “dele a dhi dy pjellësh”, që ka marrë prapashtesë tjetër.

përcëlló fol. “e djeg pak diçka përsipër”. Fjalë e mbarë gjuhës, që në gegërishte ka edhe formën *përculloj*. Formim i brendshëm me parafjalën *për-* nga emri *cull* “lëkurë” me kuptimin “djeg lëkurën”. Mund të jetë edhe me burim onomatopeik (*përc-përc*). Kamarda e pas tij Çabej e lidhin me foljen *përcjell*. Rrjedhoja të fjalës: *përcëllues* “që të përcëllon”, *përcëllimë* “zjarr me flakë të madhe; pisku i vapës”, *përcëllak* “zjarr me flakë të madhe” dhe “kulaç i pjekur në hi të nxehtë a në zjarr”. Një folje tjetër që ka të njëjtën rrënjë, është *përcëllinj* (Kristoforidhi). (Camarda I 88, Orel AED 319, Çabej SE VI 190, Luka III 299).

përçollák m. “akrep, sfurk, lat. *Euscorpius flavicandis*”. Fjalë e njohur kryesisht në toskërishten lindore; e pashpjeguar te Meyeri e Çabej. Meqenëse akrepi quhet edhe *sfurk*, *cfurk* e *cfurkth*, emri *përçollak* mund të lidhet përbrenda gjuhës me *çalle* “një lloj tërfurku me dy dhëmbë”, në gjasë të dy gëthapëve që ka akrepi përpara, vetë kjo nga folja *çaj* me prapashtesën *-llë*. Emri ka marrë parashtesën *për-* dhe prapashtesën *-ak* duke u ndryshuar zanorja e patheksuar me anë të disimitimit nga zanorja e theksuar e prapashtesës. (Meyer EW 329, Çabej SE VI 167).

përdhós fol. “fëlli, ndyj”. Fjalë e mbarë gjuhës. Mund të jetë formim i brendshëm nga *pordhë*, që ka marrë prapashtesën *-os* (khs. *vendos*, *fundos*). Për shkak të pozicionit të patheksuar, është rrëgjuar zanorja e emrit. Një burim tjetër mund të jetë folja *dhjes* me parashtesën *për-* duke u ndikuar nga prapashtesa *-os*. Prej foljes është formuar emri *përdhosje*.

përhíhet fol. “më del parasysh përfytyrimi i diçkaje që e kam jetuar, më fanitet”. Fjalë dialektore, që përdoret në formën joveprore me një trajtë të shkurtër përemërore: *më përhihet* “më del në ëndërr”. Formim i brendshëm me parashtesën *për-* dhe emri *hije*, që ka marrë bashkëtingëlloren *-h-* për zhdukje të hiatit në formën joveprore.

përkúnd fol. “tund foshnjën në djep a në shtrat për ta vënë në gjumë”. Fjalë kryesisht e dialektit gegë, e përgjithësuar në gjuhë. Është e formuar me parashtesën *për-* dhe një rrënjë **kund-*, që lidhet përbrenda shqipes me foljet *lëkund* e *shkund* e përjashta saj me rrënjën ie. **qut-* “shkund, tund”, ku bëjnë pjesë lit. *kutù*, *kutëti* “zgjoj duke tundur”, gjerm. I. vj. *scutten* “shkund”. Ka marrë epentezën e një *-n-*je para *-t-*së, një dukuri i njohur edhe në raste të tjera (khs. *bind* : ie. *b^hejd-*, *lind* : ie. *leud^h-*). Formën e thjeshtë të këtyre foljeve (pa parashtesë) e ka Figlia: *kundëshin lumërat*. Nga folja është formuar emri *përkundje*. (Meyer EW 333, Helbig 59, Treimer MRIW I 1914, 356, Bariç ARS I 49, La Piana AN V 1957, 7, Orel AED 320, Çabej SE VI 196).

përlák m. “kërriç, pulisht”. Fjalë krahinore. Formim i brendshëm nga emri *pulë*, prej së cilës është formuar edhe *pulisht* duke u përlijtur me emrin

“zogë” te pula “pulë e re”, te gomari “zog gomari, pulisht”. Ka marrë prapashtesën *-ak* dhe epentezën e një *-r-je*, si në rastin *fëli* e *fërli*. Zanojta *-u* është rrëgjuar në pozicion të patheksuar.

përpëq m. “qumështor me petë, me vezë, qumësht e djathë të njomë”. Fjalë e dy dialekteve dhe e arbërishtes së Greqisë. Formim i brendshëm me parashtesën *për-* dhe foljen *pjek* me kuptimin “gjë e pjekur” (Jokl). Bashkëtingëllorja qiellzore është e pranishme në disa forma të foljes (khs. *piq*, *piqem*, *poqa*), kurse rënia e bashkëtingëllores *-j-* është e natyrshme në një fjalë ku ka një qiellzore tjetër. Çabej nisët nga një rrënjë *pep* e së folmes së Gjirokastrës dhe e merr si krijim të gjuhës së foshnjave. (Meyer EW 357, Jokl RF II 257, Çabej SE VI 166).

përqáll fol. “i sillem dikujt rreth e rrotull duke iu fërkuar me trup (për macet); i bëj lajka dikujt”. Fjalë dialektore e gegërishtes (Logoreci). Lidhet përbrenda shqipes me *përqell* “përqesh, tall”, duke u lidhur të dyja këto me *qell* “bie, sjell, vonoj” e me *sjell* nga ie. *q^uel-* “dredh, sjell”, ku bëjnë pjesë lat. *colo-ëre* “lëroj tokën; banoj”, gr. *πέλωμαι* “lëviz”, ind. vj. *cáratī* “sjell, lëviz, vërtitem”. Ka marrë parashtesën *për-*. Raporti *qell* ~ *qall* është me karakter metafonik. (Çabej SE VI 205).

përqéth fol. “rrëqeth, ngjeth”. Me këtë formë, fjalë e gegërishtes, së cilës toskërishtja i përgjigjet me *ngjeth* e *rrëqeth*. Formim i brendshëm me parashtesën *për-* dhe foljen *qeth* “pres (flokët, leshin e bagëtive, majat e pemëve etj.)”. Folja *pres* përdoret edhe me kuptimin e të ftohtit (khs. *më preu era*; *të ftohtë që të pret*). Emri prejfoljor *përqethje* ka marrë prapashtesën *-je*.

përshkëndís / përshkëndít fol. “shpërndaj andej e këtej”. Fjalë dialektore. Formim i brendshëm nga folja *shkëndis / shkëndit* “nxjerr shkëndija”, vetë kjo prej emrit *shkëndijë, shkëndi* me prapashtesën foljore *-s ~ -t*. Kuptimi i parë konkret “shpërndahen shkëndijat” është përgjithësuar më vonë për “përhap, shpërndaj, vërvit, përshkoq etj.”. Dëshmohet së pari te Budi: *e i u kallëzuo gjithë ndezunë tue u përshkëndizunë*. Rrjedhë e foljes është emri *përshkënditje*. Prej *përshkëndit* ka dalë *shpërkëndit* me të njëjtin kuptim, e formuar ose nga *përshkëndit* me anë të metatezës, ose duke marrë prapashtesën e përbërë *sh-për*, që ka zhdukur *sh-në* e dytë me anë të disimilimit në shkallën zero.

përrúa / përrúe m. “rrjedhë uji më e vogël se lumi”. Fjalë e mbarë gjuhës, e trashëguar nga fondi indoeuropian. Lidhet me rrënjën *rēn-*, ku bëjnë pjesë got. *rinnan, rann* “vrapi”, *runs* “vrapi, rrjedhje, lumë”, isl. e vj. *run* “lidhje ndërmjet dy liqeneve”, gjerm. l. vj. *runs, runsa* “rrjedhë ujërash, lumë” (Jokl). Ka marrë prapashtesën *për-*. Forma e shumësit *përrenj* ka dalë me anë të metafonisë. Këtë formë shumësi, që del gjithandej në toskërishte, e ka edhe

Buzuku, ku fjala shfaqet së pari: *e përçark e zū endë gardh me përenjë*. Shumësi i gegërishtes *përroje* është formuar nga njëjësi me zanoren -o-. Nga njëjësi janë formuar gjithashtu *përroskë* e *përrueth* “përrua i vogël, rrëke” me prapashtesa deminutive. Ka depërtuar në toponimi: **Roj Gojanit** në Mirditë, **Përrenjas** në disa krahina, si edhe një shumicë toponimesh që përmbajnë emrin *përrua*. Me fjalën e shqipes gjuhëtarët kanë shpjeguar edhe rum. *pârîu*. Çabej e lidh me foljet *shpoj* e *shporoj* brenda shqipes e përjashta saj me gr. *πείρω* “depërtoj, shpoj”, sll. vj. kisht. *na-perjō, na-periti* “shpoj”. (Meyer EW 335, Weigand Wört. 69, Jokl IF 37, 1916/17, 91, LKU 335, Walde-Pokorny I 138, Walde-Hofmann II 438, Barić Arhiv I, 1-2, 1923, 152, Camaj AW 101, Demiraj AE 318, Orel AED 323, Çabej SE VI 214).

pëshhtëllij fol. “pëshpërit”. Fjalë dialektore. Formim i brendshëm nga një onomatope (*pësht*), që ka marrë prapashtesat -ëll + -inj (khs. *tringëllin, hingëllin*). Prej foljes është formuar emri *pëshhtëllimë*.

pilivésë f. “kandërr me trup të hollë, me krahë të gjatë e të tejdukshëm, lat. ”*Libellula vulgata*”. Fjalë e gegërishtes, që del së pari në fjalorin e Junkut. Kompozitë, e formuar nga *pili* + *vesë*. Elementi i parë është një krijim elementar a onomatopeik, i shndërruar në prefiksoid, si në rastet *piliherdhe, pilipizgë, pilipuç, pilivrom, pilingrefës* etj. Elementi i dytë është emri *ve* “vezë”, që ka marrë prapashtesën -së. (Orel AED 326, Çabej SE VI 227).

píngël f. “cingël”. Fjalë krahinore (Shqipëri e Mesme). Krijim i brendshëm nga një onomatope: *ping* (khs. *pingëron*), që ka marrë prapashtesë deminutive (khs. *cingël*).

pinók m. “pip i vogël që sapo ka dalë nga druri, bisk”. Fjalë e gegërishtes veriore (Gazulli). Formim i brendshëm nga emri *pip* “bisk, filiz, lastar”, që ka marrë prapashtesat -an + -ok (**pip-an-ok*), duke u thjeshtuar fjala me anë të haplogjisë (disimilim rrokjesor). (Topalli SF 2, 1988, 154, Luka III 320).

pisërëngë f. “pikëlore, salamandër; lat. *Salamandra maculata*”. Fjalë krahinore e dialektit toskë. Formim i brendshëm, një kompozitë nga *pis* + *rëngë*, duke shënuar elementi i parë njollat e zeza të këtij zvarraniku, çka përlligjet edhe me emërtimin latin (*maculata* “me njolla”); kurse elementi i dytë është me origjinë onomatopeike me kuptimin “tingëllimë, ofshamë” duke imituar zhurmën e zvarranikut kur ecën (*rëng-rëng*). Përdoret si patronim: **Pisrëngu** në Berat.

pispillósem fol. “vishem, krihem e stolisem në mënyrë të stërholluar e të tepruar”. Fjalë kryesisht e toskërishtes, e përgjithësuar në shqipen e sotme. Formim i brendshëm nga *pi-s-pill-os*, me prapashtesat *pi* nga *për* dhe -s-, me

emrin *pillë* “krehër” dhe prapashtesën *-os* të foljeve. Lidhet përbrenda gjuhës me foljet *pilloj* “ndreq e stolis” e *spillohem* “vishem mirë e stolisem për ndonjë rast të veçantë” dhe me emrin *pispilluq* “njeri mendjelehtë”, që ka marrë prapashtesën *-uq* me karakter pejorativ. Rrjedhoja *pispillosje* ka marrë prapashtesën *-je* të emrave prejfoljorë. (Orel AED 327).

pishlló fol. “pëshpërit”. Fjalë krahinore. Formim i brendshëm nga një onomatope (*pish*), që ka marrë prapashtesën *-(ë)ll-o* (khs. *fishkëlloj*). Një trajtë më të thjeshtë, *pishoj* e ka fjalori i Bashkimit. Si kjo folje është edhe *pishkulloj*, që ka marrë prapashtesat *-kë + -(ë)ll-o* (khs. *vishkulloj*). Me të njëjtin kuptim Kristoforidhi ka *pishtëllinj* me emrin *pishtëllimë* (*pishtëllija ndë vesh*).

pitigónë f. “vajzë a grua mendjelehtë, nazemadhe e llafazane”. Fjalë e gegërishtes veriore: *Pitigona vili-vili* (Fishta). Huazim nga it. *pettegola* “llafazane” me zhvendosjen mekanike të theksit e me ndikim të ndonjë fjale tjetër në fundoren e saj (khs. *kokonë* “kukull”).

pjekallárthi ndf. “rastësisht, gand”. Fjalë e dialektit toskë. Formim i brendshëm nga emri *pjekë* “vendi i takimit, pikëpjekje”, me prapashtesën *-llarë* të shumësit (khs. *baballarë, xhaxhallarë*) me kuptimin “njerëzit që ndeshen, që takohen” dhe me prapashtesën *-thi*, që formon ndajfolje.

pjérëz f. “shkurre dy-tre metra e lartë, që bën kokrra të zeza dhe përdoret në mjekësi e për ngjyrosje, spinaq i egër, arrç, lat. *Chenopodium giganteum*”. Fjalë e dialektit gegë (Gazulli). Formim i brendshëm me prapashtesën deminutive *-zë* nga folja *pjerdh* e përdorur si emër, e emërtuar kështu për shkak të erës së keqe, për të cilën quhet edhe *qelbina, qelbësira, shurrëpelë*. Në një grup prej tri bashkëtingëlloresh ka rënë njëra prej tyre (*pjerdh-zë > pjerzë*).

pjerr fol. “anoj mënjanoj”. Fjalë e mbarë gjuhës, e trashëguar nga fondi indoeuropian. Lidhet përbrenda shqipes me foljen *prier* e përjashta saj me rrënjën **er-* “vihem në lëvizje, ngacmoj”, ku bëjnë pjesë ind. vj. *ṛṇóti, ṛṇvāti* “ngrihet, lëviz”, av. *əṛati* “energji”, arm. *y-arnem* “ngrihem”, gr. ὄρνυμι “ngacmoj, lëviz”. Ka marrë brenda shqipes prapashtesën *për-*, duke rënë *-r-ja* para *-j-së* në një trajtë *përrjerr*, që e kanë arbëreshët e Greqisë (Johallas). Bashkëtingëllorja *-rr* është analogjike, e krijuar nga pjesorja *pjerrë*, ku *-rr-ja* ka dalë nga bashkimi me formantin e kësaj trajte (*-r + -në*). Rrjedhoja të fjalës janë: emrat *pjerrësi, pjerrinë, pjerrësirë, pjerrtësi* e *pjerrishtë* “vend me pjerrina”, emri foljor *pjerrje*; mbiemrat *i pjerrët* e *pjerrak* “i anuar”, *pjerrk* “që varet së larti” me prapashtesën *-k*, ndajfolja *pjerrtas* “shtrembër, mënjane”. (Walde-Pokorny I 136, Orel AED 330).

plándë f. “vresht”. Fjalë krahinore. Huazim nga lat. *planta* “bimë”, prej së cilës është formuar edhe *plantacion*, që kuptimisht shkon me *plandë*. Bashkëtingëllorja *-t-* është kthyer nga e shurdhët në të zëshme me asimilim të pjesshëm prej sonantes që ka pranë.

plandós fol. “e përplas, e rrëzoi përtokë”. Formim me prapashtesën *-os* të foljeve (khs. *vendos*) nga një rrënjë **plandë* me burim prej lat. *planta* “shputa e këmbës” (prej *plānus* “i rrafshhtë”) duke pasur folja *plandos* kuptimin e lat. *plantāre* “rrëzoi përtokë (me shputën e këmbës)”. Nga emri **plandë*, që është zhdukur nga gjuha, mund të jetë ndërtuar edhe *plandër* “peshë e rëndë”.

plánë f. “tokë e ulët, që vjen si gropë e mban ujë, tokë e sheshtë”. Fjalë dialektore e gegërishtes (Gazulli). Huazim nga lat. *plānum* “rrafsh, fushë, shesh”. Ka depërtuar në toponimi: **Plâ** një fushë e madhe në Has, si edhe disa toponime me emrin **Plan** (Shkodër, Mirditë etj.), duke kaluar prej toponimisë në patronimi: **Plani** në Shkodër. (Luka III 326).

plapurítem fol. “përpëlitem”. Fjalë krahinore. Formim i brendshëm nga një onomatope (*plap-plap*), që ka marrë prapashtesat *-(ë)r > -ur + -it* (khs. *çuçurit, pllaqurit*). Prej foljes është formuar emri **plapuritje**.

pleng m. “kunj për të varur diçka”. Fjalë dialektore e gegërishtes. Lidhet përbrenda shqipes me **pjek** “shkop i gjatë, me të cilin godasin cinglin në lojën me cingla” e me **plengë** “hobe”, të gjitha këto nga rrënja *plek-* “godas”, ku bëjnë pjesë gr. *πλήσσω* “godas”, lit. *plakù* “godas, qëlloj”, bullg. vj. *plača, plakati* “goditem në kraharor”. Ka marrë bashkëtingëlloren *-n-* si epentezë para grykores.

plim m. “tufë, varg”. Fjalë me përhapje krahinore kryesisht në gegërishte; e trashëguar nga fondi indoeuropian. Lidhet me rrënjën *plē-* “mbush”, ku bëjnë pjesë lat. *com-plētus* “i plotë”, irl. vj. *līnaim* “mbush”, gr. *πίπτει* “mbush”, got. *fulls* “plot”, ind. vj. *purú* “shumë”. Ka marrë formantin *-m* të pjesores. Përbrenda shqipes lidhet me *plot*, që ka një tjetër shkallë vokalike dhe ka marrë formantin *-t* të pjesores. Me *plim* lidhet **plimëra**, një formë shumësi (tosk.) me kuptimin “të përbrendshmet e bagëtime”. (Orel AED 334).

pllaqurítem fol. “përplas këmbë e duar në ujë”. Fjalë e dialektit toskë. Formim i brendshëm nga një onomatope (khs. *pllaq-plluq*). Ka marrë prapashtesat *-(ë)r > -ur + -it* (khs. *çuçurit, plapuritem*).

po psz. “mirë, ashtu”. Përdoret me vlerën e një fjalie, kur pranojmë a kur miratojmë diçka” dhe si lidhës bashkërenditëse me marrëdhënie kundërshtore (*jo unë, po ti*), ashtu edhe si lidhës nënrenditëse kushtore (*po erdhi ..., po të vijë ...*). Prej pohimit ka dalë edhe pjesëza *po*, që shpreh

vazhdimin e veprimit (*po punoj*). Është fjalë me burim të trashëguar, por lidhja e saj me fondin indoeuropian paraqitet e vështirë, meqenëse gjuhët e kësaj familjeje (ndryshe nga pjesëzat mohuese) nuk kanë pasur një fjalë të përbashkët për të shprehur pohimin (khs. ang. *yes*, it. *si*, fr. *oui*, rus. *da*). Mund të lidhet brenda gjuhës me lidhëzën *por* dhe ndoshta me parafjalën *pa* me një tjetër shkallë vokaliqe. Lidhja ndërmjet *por* e *po* ka ngjashmëri me *kur* e **ku* (në *kush*, *kû*, *kujt*). Dëshmohet së pari te Buzuku: *E ama po ruon endë zemërë gjithë këto fjalë*. Me këtë pjesëz janë formuar: ***pohe***, ***pohës***, ***pohoj*** e ***ripohoj*** me emrat ***pohues***, ***pohim*** e ***ripohim***; mbiemri ***pohor***, duke marrë të gjitha bashkëtingëlloren *-h-* për zhdukje të hiatit (khs. *mohoj*); fjalët e përngjitura ***posi*** nga *po* + *si*, ***posikundër***, ***posikundërse*** (Budi) e ***posikundërqë*** nga *po* + *sikundër*, ***pothuaj*** “gati, afro” nga *po* + *thuaj*, ***poende*** “madje, për më tepër” nga *po* + *ende* “edhe, akoma”, ***poqë*** “posa, sapo” nga *po* + *që*, ***mirëpo*** nga *mirë* + *po* etj. Prej shqipes ka hyrë në disa të folme serbokroate. (Weigand Wört. 71, S. Hoxha 143).

por I. Lidhëz bashkërenditëse kundërshtore, e trashëguar. Mund të lidhet brenda gjuhës me parafjalën *për* me një tjetër shkallë vokaliqe, me pjesëzën *po* me një lidhje të ngjashme me *kur* e **ku* (*kush*, *kû*, *kujt*). Dëshmohet së pari te Buzuku: *atë ditë punë en dore mos zāsh aspak, por ajo ditë tÿ të duhetë shkuom ende e dashunë Tenëzonë*. Me këtë lidhëz janë formuar: ***porse*** nga *por* + *se*, ***porsi*** nga *por* + *si*, me shkurtim të brendshëm ***posi***; ***porsa*** nga *por* + *sa*, me shkurtim të brendshëm ***posa***; me metatezë ***sapo***; ***posaqë*** me lidhëzën *që*. Prej shqipes ka hyrë në disa të folme serbokroate. (S. Hoxha 144).

poshtëj fol. “dështoj, shtie pjellën”. Fjalë krahinore (geg. VL). Formim i brendshëm nga folja *shtie*, që ka marrë parashtesën *po-* ose *për-* dhe prapashtesën *-o*. Nga kjo folje është formuar edhe sinonimi *dështoj* (*dë-* + *shtie* + *-o*).

praj fol. “pushoj”. Fjalë dialektore e gegërishtes veriore. Formim i brendshëm nga *për-* + *ajem* “ënjtem”. Folja *ajem* lidhet me të folurit në atë dialekt; khs. *u aja tue folë*; kurse *praj* është “heshta, nuk fola, pushova”. Prej foljes është formuar emri ***prajë*** “prehje, pushim” sipas emrave *vrajë*, *blojë*, *lojë* etj. Formime nga folja janë edhe ***i prajshëm*** “i çlodhur, i pushuar” dhe ***prajsë*** “vend pushimi gjatë rrugës”, që ka marrë prapashtesën *-së*. (Weigand Wört. 71, Luka III 346).

prëhër / prëhën m. “pjesa nga gjunjët deri te barku kur rrimë këmbëkryq”. Fjalë e mbarë gjuhës, që e kanë edhe arbëreshët e Italisë e të Greqisë. Mund të jetë e trashëguar dhe të lidhet me rrënjën *perġ-* “brinjë, gjoks”, ku bëjnë pjesë ind. vj. *parġu-h*, av. *parəsu-* “brinjë”, bullg. vj. *prəsi*

“kraharor” (për shndërrimin $-k̂- > -h-$, khs. *vjehërr* : ie. *sūékur*). Fjala është një shumës i singularizuar me formantin e shumësit $-(ë)në / -(ë)rë$. Bashkëtingëllorja $-n-$ e formantit të shumësit është rishfaqur në trup të fjalës (**preⁿhënë*), me çka shpjegohet zanorja hundore në dialektin gegë. (khs. edhe *krâhën / krëhër*). Ka qenë emër i gjinisë asnjane, sikurse dëshmohet te Buzuku: *as aj qi bân duorëzëtë s mujti me embushunë prehënit e t̄i*. Çabej e nxjerr nga folja *âj / ënj*. (Meyer EW 353, Walde-Pokorny II 44, Orel AED 342, Topalli SF 1-2, 1998, 47, Çabej SE VI 246, Luka III 350).

prej prf. “nga”. Tregon pikënisje, lëndën nga e cila është bërë diçka etj. Fjalë e mbarë gjuhës, me përdorim më të shumtë në gegërishte, më pak në toskërishte, ku konkurrohet prej parafjalës *nga*. Formim i brendshëm i shqipes nga parafjala *për*, që është bashkuar me nyjën e përparme të mbiemrave të emëruar duke kaluar nëpër shkallët *për > pr + e > pre-j*. Këto shkallë zhvillimi i gjejmë te Buzuku: *duhetë një me vdekunë për popullit; bekuom aj qi vjen pr emënë të Tinëzot; u t u dërgonj prej Atit*. Bashkëtingëllorja $-j-$ fundore ka ndërhyrë për të zhdukur hiatin me emrat që nisin me zanore; por më vonë është përgjithësuar edhe për emrat me bashkëtingëllore; Buzuku: *E i thiri engjëlli Tinëzot prej qiellshit*. Nga këto dy parafjalë *për* është më e lashtë, meqenëse e ka rrëgjuar zanoren në trup të saj dhe përdoret me rasën kallëzore; kurse *prej* është më e re dhe e dalë prej së parës, meqenëse e ka ruajtur zanoren të parrëgjuar dhe përdoret me rasën rrjedhore. Fjala dëshmohet me formën *pri* në njërin prej dokumenteve më të hershme të gjuhës shqipe, në Perikopenë e Ungjillit (shek. XV-XVI): *pri shin Mathtë ungjill*. Me parafjalën *prej* është formuar lidhëza *prejse*. (Pedersen Fest. Thomsen 1894, 242, Camaj AW 110, Orel AED 343, Topalli Nyjat 227).

prek fol. “takoj lehtë me dorë a me diçka tjetër”. Fjalë e mbarë gjuhës, e trashëguar nga fondi indoeuropian, me burim të paqartë. Lidhet përbrenda gjuhës me foljen *rrek ~ rrekem e rrok ~ rrokem*, që kanë pasur si kuptim konkret “kap, takoj” dhe meqenëse veprimi i të kapurit kryhet me dorë, në shkallë indoeuropiane këto fjalë lidhen me një rrënjë **rek-*, prej së cilës ka dalë let. *ruoka*, rus. vj. *pyka* “dorë”. Dëshmohet së pari te Buzuku: *Tue prekunë me dorë shumë kafshë qi janë kondra arëseut Tinëzot, tue pasunë të pëlqyem me prekunë gjanë e uoj*. Rrjedhoja të fjalës: *prekje, prekës; i prekshëm, i paprekshëm, prekshmëri e paprekshmëri, prekatar* “që di të sillet me të tjerët”, *prekë* “vrugu i bimëve” dhe “pika të murrme a të kuqërreme që dalin në fytyrë”, e formuar në shprehjen *e ka prekë sëmundja; prekël* “birth, antenë”. (Camarda I 242, Meyer EW 352, Vasmer REW III 515, Orel AED 343).

prémte (e) f. “dita e pestë e javës, dita pas së enjtes”. Fjalë e mbarë gjuhës, me burim të errët. Për burimin e saj janë shprehur shumë gjuhëtarë.

Mund të lidhet përbrenda gjuhës me *pramë* “mbrëmë” (Meyer), domethënë një ditë para së shtunës, meqenëse e premtja ka qenë dita e fundit të latinët, që e nisnin numërimin e ditëve nga e shtuna. Pjesa fundore *-te* është prapashtesë sikurse të *e enjte*, kurse nyja e përparme *e* është si në emrat e tjerë të javës, ku është formuar me anë të një elipse nga *dita e premte*. Dëshmohet së pari te Buzuku: *Ecë përhapëtë të premtënë e madhe e vgjāj*. Ka depërtuar në antroponimi: **Prend**, **Prendë** (Veri), **Premto** (Jug); në patronimi: **Prendi**, **Prendushi** (Veri), **Premtja** (Jug). (Mjedja Leka IV 1932, 351, Treimer Arhiv I, 1-2, 1923, 32, Ölberg IWA 27, Bokshi SFS 2008, 317, Orel AED 343).

pres ~ preva fol. “heq a ndaj një pjesë nga e tëra, copëtoj”. Fjalë e mbarë gjuhës, e trashëguar nga fondi indoeuropian. Krahasimi i së tashmes *pres ~ pret* me pjesoren *pre / prerë* dhe me të kryerën e thjeshtë *preva* nxjerr në dritë se *-s ~ -t* janë mbaresat e së tashmes, si të *vras ~ vret ~ vra / vrarë*. Tema *pre* rrjedh nga *preh* “mpreh”, e formuar nga *për-eh*; ku rrënja *eh* lidhet përbrenda shqipes me emrin *teh* nga *t- + eh* dhe përjashta saj me rrënjën *ie. ak-* “i mprehtë, majë”, ku bëjnë pjesë gr. ἄκρος, lat. *acus, acidus* “i thartë”, arm. *asehn* “gjilpërë”, lit. *asztrūs*, sll. vj. kisht. *ostrъ* “i mprehtë”. Dëshmohet së pari te Buzuku, që ka formën me parashtesë të pareduktuar: *E i përenë krÿetë endë burg; e kush përÿt glemba en ullini, e i shtronjinë pr udhët*. Rrjedhoja të fjalës: **preyje** e **preyje**, **prejës**, **presë**, **presje** “shenjë pikësimi”, **prejëse**, **prejazi**, **paprerë**, **papreras**, **i paprerë**; **ndërpres**, **ndërpresje**, **ndërpresës**, **i pandërpresë**; **prestar** e **prestarë**. (Camarda I 42, Meyer EW 352, Walde-Pokorny I 32, Tagliavini AD 227, Schmidt KZ 50, 1922, 243, Mann ICD 13, Huld BAE 105, Çabej SE IV 67, Demiraj AE 332, Orel AED 343, Luka III 353).

pres ~ prita fol. “rri në një vend”. Fjalë e mbarë gjuhës. Nuk ka lidhje me *pres ~ pret* “ndaj, copëtoj”, meqenëse te kjo folje *s- ~ t* janë mbaresat e së tashmes (khs. përndryshe *preva ~ prerë*); kurse të *pres ~ prita* bashkëtingëllorja *-t* është pjesë e rrënjës (khs. *prita ~ pritur*). Edhe kuptimisht dy foljet janë larg njëra-tjetrës. Folja *pres ~ prita* është e formuar me parashtesën *për-* nga rrënja *et-* (*përes ~ përet*) duke u lidhur përbrenda shqipes me foljet *jes ~ jet* e *mbes ~ mbet* (*mbë- + -et*) dhe me emrin *jetë*. Rrënja *et-*, *jet-* është forma e vetës II shumës të foljes *es-* “me qenë” në një paradigëmë të hershme: *jemë ~ *jetë ~ janë*, ku forma e vetës II shumës është zëvendësuar nga forma më e re *jeni* me mbaresën e foljeve me *-nĭō*: *jeni* si *bani / bëni*. Kësisoj, folja *jet* krahasohet në plan indoeuropian me format e vetës II shumës me mbaresën *-t*: gr. εστῆ, sll. vj. *jeste*, got. *sijub*. Duke pasur si pikënisje trajtën e vetës II shumës folja ka zhvilluar një paradigëmë të plotë zgjedhimi. Dëshmohet së pari te Buzuku: *A ti je aj qi kã me ardhunë, o tjetërë presmë?* Rrjedhojat e fjalës janë krijuar nga forma e pjesores: **prité** “ledh prej dheu e gurësh” dhe “vend i fshehtë ku dikush rri në përgjim”, **pritje** e **pritës**, **i pritmë**,

pritmëri, e **pritme** “koha e ardhme”, **i pritshëm** e **pritshtëri**; **parapritë**, **parapritje** e **parapritës**; **pritar** “ai që del në pritje”. (Camarda I 143, Bugge BB XVIII 1891, 169, Barić ARS I 90, Tagliavini AD 228, Hamp KZ 76, 1959, 135).

príer fol. “anoj”. Fjalë e mbarë gjuhës, e trashëguar nga fondi indoeuropian. Përmban parashtesën *për-* dhe rrënjën **er-* “vihem në lëvizje, ngacmoj”, ku bëjnë pjesë ind. vj. *ṛṇōti*, *ṛṇvāti* “ngrihet, lëviz”, av. *arəti* “energji”, arm. *y-arnem* “ngrihem”, gr. ῥῆνυμι “ngacmoj, lëviz”. Dëshmohet në Perikopenë e Ungjillit (shek. XV-XVI) me kuptimin “kthehem”: *tha se për tre ndit përiremi*. E ka edhe Buzuku me kuptimin “përmbys”: *e përnuor trÿesëtë e atÿne qi endëronjinë denarë*. Rrjedhoja të fjalës: **prirë** “kurrizi i këmbës” me prapashtesën *-ë* (khs. *dekë, veshë*), **prirje** “veti”, **i prirët** “i pjerrët”. Rrjedhoja të tjera lidhen me foljen **pjerr** nga *për-jerr*. Të tilla janë: emrat **pjerrësi**, **pjerrinë**, **pjerrësirë**, **pjerrtësi**, **pjerrishtë**, **pjerrje**; mbiemrat **i pjerrët**, **pjerrak**, **pjerrk** “që varet së larti”; ndajfolja **pjerrtas** “shtrembër, mënjane”. (Meyer EW 354, Walde-Pokorny I 136, Orel AED 344).

prij fol. “i tregoj rrugën dikujt, udhëheq”. Fjalë e mbarë gjuhës, e trashëguar. Lidhet brenda gjuhës me numërorin *i parë* e përjashta saj me rrënjën *pryo-* “i parë”, ku bëjnë pjesë ind. vj. *purvaḥ*, sll. vj. *пръвъ*, lit. *pirmas*, gr. πρῶτος, lat. *primus*. Zanozja *-i-* në vend të zanores *-a-* mund të ketë lidhje me reflekset e sonanteve të trashëguara indoeuropiane; kurse pozicioni i vetë lëngzores shpjegohet me përbërjen rrokjesore të fjalës së shqipes (khs. *krimb*). Një shpjegim tjetër mund të jetë me mjetet e brendshme të shqipes: numërori *i parë* ka marrë prapashtesën *-inj* të foljeve duke shkaktuar rënien e zanores së patheksuar (*parë* + *-inj* > *prinj*). Fjala dëshmohet në njërin prej dokumenteve më të hershme të gjuhës shqipe, në Perikopenë e Ungjillit (shek. XV-XVI): *prinin*. Rrjedhoja të fjalës janë: **prijatar** “ai që prin, që heq udhën”, **prijë** “udhëheqje”, **prijës** “udhërrëfyes”; me parashtesë **paraprij** e **paraprijës**. (Meyer EW 353, Haarmann Lat. Lehn. 143, Orel AED 345).

prijë f. “vijë e thellë që kalon përmes arës”. Fjalë e dialektit gegë, me përhapje të gjerë në të folme të ndryshme dhe me kuptime të shumta: “rrëke e vogël”, “kurrizi i hullisë”, “vullajë, lehe”, “varg pemësh në fund të një are”, “vullajë qepësh”, “rresht hardhijash” etj. Në të gjitha rastet del kuptimi “vijë, udhë”. Formim i brendshëm nga folja *prij*, që lidhet në të gjitha format me emrin “udhë”: *prij* “i tregoj udhën dikujt”, *prijë* “udhëheqje”, *prijës* “udhërrëfyes”. Prej këtyre fjalëve është zhvilluar kuptimi konkret “udhë, vijë” duke marrë kuptime të ndryshme për “vijë, hulli, rrëke etj.”. Rrjedhoja **prijëz** ka marrë prapashtesë deminutive. (Luka III 359).

prik m. “pjerrje”: *shtëpi me prik* “shtëpi me çati të pjerrët”. Fjalë dialektore e gegërishtes (Gazulli). Formim i brendshëm me prapashtesën *-k* nga folja *prier*, me zhdukjen disimilatore të njëres prej dy lëngëzoreve të njëjta dhe me rënien e zanores së patheksuar *-e-*. (**prier-k* > *prik*). (Orel AED 345).

prish fol. “çart, shkatërroj”, “rrënoj, shemb”, “dëmtoj, vras”, “shpenztoj, harxhoj”. Fjalë e mbarë gjuhës me shumë kuptime; me burim të paqartë. Mund të jetë fjalë e trashëguar, që lidhet me rrënjën ie. *prīs-* “grij, copëtoj”, ku bën pjesë gr. *πρις-πρίω* “sharroj” (Meyer). Çabej e merr si zhvillim të brendshëm duke e lidhur me *përshij* e më tej me *shij*, ku duhet thënë se rruga e zhvillimit ka shkuar në krah të kundërt: nga *prish* ka dalë *përshij* “copëtoj e thërroj bukën”. Dëshmohet te Budi: *kusarëtë, e grabitarëtë, zotënitë e këqī, e të pamëshërier, qi prishnjënë, e rjepënë vobëzënë*. Rrjedhoja të fjalës: *prishje, prishës, prishan* “i prishur në fytyrë (nga një sëmundje etj.)”, *prishanik, prisharak* “që prish shumë para pa nevojë”, *i prishur* e *i paprishur; përprish* “e prish fare, e shkatërroj krejt” me kuptim intensiv; prej foljes edhe emri *përprishje* e mbiemri *i përprishur*; me parashitesën *sh-*: *shprish* “shkrif leshin me duar; punoj tokën lehtë; shtie diçka në gojë”; kompozitat *prishalesh* “ai që lëtur lesh”, *shprishalesh* “gërhanë”, *prishaqefas* “pa qejf”, *plangprishës* “shkapërdar” etj. (Meyer EW 353, Jokl Stud. 72, Walde-Pokorny II 89, Boisacq 813, Demiraj AE 333, Orel AED 346, Çabej SE VI 247).

próçkë f. “punë a fjalë e papeshuar, gabim trashanik”. Fjalë e dialektit toskë. Formim i brendshëm, që lidhet përbrenda shqipes me *broçkulla*, fjalë e anëve të Jugut, që del me kuptimin “dokrra, fjalë boshe, gjepura”. Te emri *proçkë* kemi formën pa prapashtesë.

prófkë f. “pushkaliqe, stërfytës, stërlagës; gjepura, dokrra”. Fjalë e dialektit toskë. Krijim i brendshëm nga një onomatope, imitim i krismës (*prof*, khs. *brof*). Ka marrë prapashtesën *-kë*. Në kuptimin “gjepura, dokrra” ka krijuar rrjedhojën *profkatar*. (Jokl LKU 9, Orel AED 346).

próshkët (i) mb. “që sapo është këputur (për pemët a perimet), i freskët, i njomë”, “që sapo ka dalë nga zjarri”. Fjalë krahinore. Krijim i brendshëm, që lidhet me fjalët e toskërishtes jugore *boshkë* e *boçkë, fik boçko* “i papjekur”, më tej me *boçka* e *broçkulla* “dokrra”, kjo e fundit me epentezën e një *-r-*je. Tek *i proshkët* afrikatja *-ç-* ka kaluar në *-sh-* nga ndeshja me grykoren (khs. çam. *shklata* nga *ç kle ata*, geg. *shka* nga *çka*) dhe bashkëtingëllorja e zëshme ka kaluar në të shurdhët. Nga *i proshkët* ka dalë emri *proshtimë* “lëkurë që sapo është rrjepur”, që ka marrë prapashtesën *-imë* duke u lidhur kuptimisht me mbiemrin nëpërmjet idesë “gjë e freskët”. Në këtë

fjalë, në grupin e formuar prej tri bashkëtingëlloresh ka rënë njëra prej tyre (**proshktimë* > *proshtimë*).

prozhmój fol. “flas keq për dikë pas shpine”. Fjalë krahinore e gegërishtes, me burim të paqartë. Mund të lidhet përbrenda gjuhës me *proçkë* (**proç-kë*) e *broçkulla* (**broç-k-ull-a*), rrënja e të cilave, një **proç-*, ka marrë prapashtesën *-(ë)m* dhe ka kthyer afrikaten *-ç-* në *-sh-*, duke u zëshmuar kjo e fundit nga sonantja *-m*. Me këtë rrugë do të jetë formuar së pari emri *prozhëm*, që rron edhe sot në të folmet veriore (*Mos po ban prozhëm?* “mos po tallësh?”), duke u formuar prej tij folja *prozhmoj*. Sipas Xhuvanit, *prozhmoj* ka dalë nga *përçmoj* “e përbuz, nuk e vlerësoj”. Rrjedhoja të foljes janë emrat **prozhmim** e **prozhmues**. (Camarda I 322, Meyer EW 355, AS VI 52, Xhuvani BSS 1, 1956, 106, Orel AED 347, Çabej SE VI 249).

prúaj / prúej fol. “ruaj, mbroj”, “i bie pas një sëmundjeje duke bërë mjekime popullore”, “pretoj, plaçkit”. Fjalë e mbarë gjuhës me kuptime të shumta, që largohen mjaft nga njëri-tjetri. Huazim nga lat. *parāre* “përgatis”, e cila në latinishten vulgare ka zhvilluar edhe kuptime të tjera, që afrohen me ato të shqipes; khs. në italishte: “mbroj”, “ruaj”, “mënjanoj” etj. Për kuptimin “pretoj, plaçkit”, që s’e kanë gjuhët romane, mund të ketë ndërhyrë emri *pre*, që fonetikisht afrohet me foljen. Zbërthimi në diftong i zanores *-o-* në sistemin foljor është i njohur edhe për disa huazime të tjera latino-romane, si: *rruaj* nga lat. *rādēre*, *truaj* nga lat. *trādēre*, *paguaj* nga it. *pagare*. Forma më e hershme e foljes është *përuanj*, që e ka Buzuku me kuptimin “mbroj”: *ti tue i përuom, ata klofshinë ruojtunë endë mende*. Me këtë kuptim edhe te Budi; kurse Bardhi e ka për “rrenoj, përmbys”: *Me pruejtunë e me rëzuem për dhë* “Profligare”. Rrjedhoja të foljes janë emrat **projë** “plaçkë” (Gazulli), **prrojë** “mjekim” (Xhuvani), që kanë marrë bashkëtingëlloren *-j-* për zhdukje të hiatit (khs. *luaj* e *lojë*, *bluaj* e *blojë*). Të njëjtin burim nga latinishtja ka folja **mbroj**, që ka marrë protezën e një *m-*je; por zanorja *-o-* e pazbërthyer në diftong te kjo folje është shenjë e moshës më të re se *pruaj / pruej*. (Luka III 365).

púçërr f. “kokërr e vogël në lëkurë, zakonisht e mbushur me qelb ose me ujth”. Fjalë e mbarë gjuhës. Formim i brendshëm nga emri *puç* “majë”, që ka marrë prapashtesën *-(ë)rr* (khs. *kokërr*). Rrjedhoja të fjalës: **puçrrak** e **puçrranjoz** “i mbushur me puçrra”, të formuara me numrin shumës; **puçërriza** “puçrra të vogla”, një shumës i singularizuar; foljet **puçërrhem**, **puçërrsem** e **puçërrizem** me emrat **puçërrim** e **puçërrrosje** etj. (Orel AED 348).

púfkë mb. “flluskë në lëkurë, në gjethet e disa pemëve etj.”, “pikë uji, loti etj.”, “pupagjel”, “shtëllungë e vogël tymi a pluhuri”, “mafishe”, “mushkëri”, “arrë fyrbë”. Fjalë e gjuhës bisedore me përhapje të gjerë e me

shumë kuptime. Krijim i brendshëm me prapashtesën *-kë* nga një onomatope, si imitim i zhurmës që bëjnë flluskat kur shpohen (*puf*). (Orel AED 348).

pulisht m. “kërraç”. Fjalë me përhapje të gjerë në të dy dialektet. Lidhet përbrenda gjuhës me *pulë* (Meyer), meqenëse, kur është e re, quhet *zogë*. Edhe gomari, kur është i ri, quhet *zog gomari*, çka ka bërë të mundur kalimin e emrit të pulës tek ai i gomarit. Ka marrë prapashtesën *-isht*. Për këtë emër, arbëreshët e Italisë kanë *pular* e *pulistër*, të ndërtuar nga e njëjta rrënjë, por me prapashtesa të tjera. (Meyer EW 357, Weigand Wört. 72, Orel AED 349).

púpë f. “larva e disa kandrrave, e mbështjellë me një fshikëz të mbyllur”. Krijim elementar për diçka të vogël e të rrumbullakët a të fryrë. Si i tillë, lidhet përbrenda gjuhës me *bubë* “vëmje e rritur para se të shndërrohet në flutur ose në krimb”, “krimb mëndafshi”, “rre, glistër”, lat. *Lumbricus terrestris*, “morr i vogël”. Kuptimi “gjë e vogël, e rrumbullakët” del edhe në rrjedhojat e fjalës: *pupërr* “puçërr e vogël” me prapashtesën *-(ë)rr* (khs. *kokërr*), *puprri* “kokërriza shumë të vogla në sipërfaqen e gjuhës” me prapashtesën *-i* të shumësit kolektiv; *pupërriqe* “mornica” me prapashtesën *-iqe* (khs. *gardhiqe*), që përdoret vetëm si shumë; *pupërrohem* “më bëhen mornica në trup”, “mbushem me puprra”, *puprriqem* “më shkojnë mornica në trup; mblihem nga të ftohtit” nga shumësi *puprriqe*; *pupuloj* “mbush diçka plot e përplot” me prapashtesat *-ël > -ul- + -o* (khs. *çapëloj*, *copëloj*); nga kjo mbiemrat *pupulak* e *pupulake* “me trup të shëndoshë e të mbushur” me prapashtesën *-ak* (khs. *topolak-e*). Kuptime të tjera që ka zhvilluar ky emër, janë: “boçë”, “tufë”, “gonxhe, bulë”, “veshul, bistak”, “kaçul, xhufkë”, që dalin sidomos në fjalët me prapashtesën deminutive: *pupë pambuku* “boçë, tufë”, *pupa bari* “tufa bari”; *pupëz* “zog shtegtar me trup sa të pëllumbit, lat. *Upupa epops*”; “çafkëlorja, lat. *Alauda cristata*”, prej saj edhe folja *pupëzon* “këndon (pupëza)”; *pupëza e flokëve* “tufë”; *çeli pupëza* “gonxhja, bula”. (Meyer EW 358, Weigand Wört. 72, Camaj AW 125, Svane SLA 148, Demiraj AE 336, Orel AED 350, Luka III 379).

pupurít fol. “gërryen dheun me këmbë për të gjetur ushqim (për pulën a për ndonjë shpend tjetër)”. Fjalë krahinore. Krijim i brendshëm nga një onomatope: (*bën*) *pur-pur*, si imitim i zhurmës që bën pula kur gërryen dheun me këmbë. Në një bazë **për-për*, me dyfishim, ka rënë njëra prej lëngëzoreve me anë të disimilitit në shkallën zero (khs. *shushurin* nga **shur-shur*). (Meyer EW 358, Luka III 387).

puq fol. “afroj, bashkoj, puthit”. Fjalë e mbarë gjuhës, që përdoret edhe si ndajfolje me kuptimin “afër, ngjitur”. Lidhet përbrenda shqipes me foljen *pjek* “takoj, ndesh, prek, çik, përputh”. Forma *puq* ka dalë prej trajtës

joveprora *puqem*, ku mbaresat *-em ~ -esh ~ et* etj., të përbëra nga zanorja *e-*, i kthejnë grykoret në qiellzore. Raporti fonetik ndërmjet *pjek* e *puq* është ai i foljeve *shpie ~ shpura*, *shtie ~ shtura*, *vê ~ vuna / vura*, raporte të apofonisë kualitative, ku trajtat me apofoni në disa folje dalin si forma kohore, kurse në disa të tjera kanë dalë si folje më vete (khs. *pjerdh ~ purthem*). Emri *puqje* është formuar nga folja. (Orel AED 350).

puró fol. “e mbaj larg, nuk e lë të afrohet”: *puronte pulat; puroji qentë*; “ruaj, mbroj”: *e puroi nga bagëtia; e puroi gjyshi*. Fjalë dialektore. Lidhet përbrenda gjuhës me *përuaj, përoj*, një folje me shumë kuptime, ndër të cilat edhe “largoj, mënjanoj” e “ruaj, mbroj”. Vetë *përoj* është huazim nga lat. *parāre* “përgatis”, që në latinishten vulgare ka zhvilluar edhe kuptime të tjera, ndër të cilët “ruaj”, “mbroj”, “mënjanoj, largoj” etj. Fonetikisht, te *puroj* zanorja e rrëguar është kthyer në *-u-* me anë të asimilimit nga bashkëtingëllorja *p-*. (Jokl Stud. 112, Orel AED 351).

pusétë f. “gropë që hapet mbi një kanal të nëndheshëm”. Fjalë e re në gjuhën shqipe. Huazim nga it. *pozetto*, prej *pozso* “pus” + *-etto* prapashtesë deminutive, me ndërhyrjen e emrit *pus*.

pushtó fol. “marr me forcë një vend”. Fjalë e mbarë gjuhës. Formim i brendshëm i shqipes nga emri *pushtet* me prapashtesën *-o* të foljeve (Meyer), duke u thjeshtuar në njërën rrokje me anë të haplologjisë. Çabej burimin e kësaj foljeje e lidh me *pushtroj* “mbuloj”. Dëshmohet së pari te Buzuku: *Zotÿnë muo më pushtoi ende e zanët enfill të udhëvet tÿ*. Rrjedhoja të fjalës: emrat prejfoljorë *pushtim, pushtues* dhe mbiemri *i pushtueshëm*. (Meyer EW 359, Haarmann Lat. Lehn. 92, Çabej SE VI 253).

pútër f. “shputa e këmbës e disa kafshëve a e njeriut”, “tabani i çorapit”. Fjalë e mbarë gjuhës, e trashëguar nga fondi indoeuropian. Brenda shqipes lidhet me *putë* e *shputë* dhe përjashta saj me fjalën “këmbë” të gjuhëve të tjera: ind. vj. *pad-* “këmbë”, gr. *πῶς, πούς*, gjin. *ποδός* “këmbë”. lat. *pēs*, *pēdis* “këmbë”, got. *fōtus*. Ka marrë prapashtesën *-(ë)r*. (Orel AED 352).

pýkë f. “copë druri a metali, e mprehtë nga njëra anë, që përdoret për të çarë dru”. Fjalë e mbarë gjuhës, me burim të paqartë. Duke u mbështetur në format që jep Meyeri: *pyjë* nga Rossi, *pylkë* nga Kavalioti, mund të rindërtohet baza e saj **pilkë*, që lidhet brenda gjuhës me *pilcë* “lloz, levë”, një rrjedhojë e emrit *pilë* “tra që i vihet murit për së gjati”, “këmbë ure” etj. Te *pyjë* emri ka marrë prapashtesën deminutive *-kë*, duke krijuar grupin bashkëtingëllor *-lk-*, që ka ndjekur rrugën e tij të evolucionit dialektor. Zanorja *-i-* është kthyer në *-y-* me anë të asimilimit prej bashkëtingëllores *p-* me karakter buzor. Rrjedhoja të fjalës: foljet *pykoj* “çaj drurin me pykë”, *pykëzohem* “hyj si pykë në thellësi të ushtrisë armike”; emrat *pykël* “copë e

vogël druri, cifël druje”, *pykëz* “pykë e vogël”, të formuara me prapashtesa deminutive; *pykëzim*, e formuar prej foljes *pykëzohem*. (Meyer EW 360, Orel AED 353).

Q

qápë f. “pengojcë prej druri, në trajtë bige, që i vihet kalit në këmbët e para”. Fjalë krahinore e gegërishtes. Lidhet përbrenda gjuhës me *çapë* “vegël bujqësore që ka një teh si sqepar në njërin anë dhe dy dhëmbë në anën tjetër”, më tej me *kërçabë* “pengesë që u vihet derrave në qafë për të mos bërë dëme”, duke dalë të gjitha nga emri *çap* “hap”. Ndërrimi i afrikates -ç- me qiellzoren -q- është dukuri dialektore e shumë të folmeve gege. Prej emrit është formuar folja *qapoj* “i vë mandallin derës a dritares”, “kap dhe nuk e lë të ikë, e mbërthej”. (Orel AED 354, Luka IV 3).

qártë (i) mb. “i pastër e i tejdukshëm, i kthjellët”. Fjalë e mbarë gjuhës. Huazim nga it. *chiaro*, që ka marrë prapashtesën -të të mbiemrave. Grupi -kj-, që është ruajtur në trajtën *i kjartë* të gegërishtes veriore, është shkruar duke dhënë qiellzoren -q-. Rrënja e fjalës ruhet te folja *sqaroj* nga *s-qar-o*, geg. *skjaroj*. Formën pa prapashtesë e ka Bogdani: *atyne u duk aj yll i qarë*. Del edhe te Variboba: *illi i qār*. Një burim nga lat. *clārus* (Orel) duhet përfshirë, për arsye se formën me grupin *kl-* nuk e ka asnjë e folme e shqipës. Rrjedhoja të fjalës: mbiemri *i paqartë*, emrat *qartësi* e *paqartësi*, folja *qartësoj*, ndajfoljet *qartë*, *qartas*, *qartazi* e *qartësisht*. (Camarda I 56, Miklosich AF II 15, Meyer EW 220, Tagliavini AD 93, Orel AED 354, Luka IV 6).

qasón fol. “del a pikon nga pak ujë”. Fjalë krahinore. Formim i brendshëm nga *qaj* me kuptimin “pikon, rrjedh nga pak”, që ka marrë prapashtesën -so të foljeve. Forma dialektore *kjason* (Gazulli) dëshmon burimin e fjalës nga *kjaj* “qaj”. Prej foljes është formuar emri *qasinë* “tokë që qason ujë”.

qe psz. “ja”. Fjalë e gegërishtes. Huazim nga lat. *ecce* me të njëjtin kuptim. Dëshkohet te Kuvendi i Arbënit (1706): *qe unë vet*. Merr pjesë në formimin e disa përemrave dëftorë, si: *qaj / qat, qajo* “pikërisht ai, ai vetë, ajo vetë” nga *qe + aj* (formë dialektore për *ai*). Trajta *qat* është krijim gjuhëtarësh, e formuar duke zëvendësuar përemrin *aj* me *at*. Forma e mocionit *qajo* përmban përemrin *ajo*. Me këtë pjesëz janë krijuar edhe disa ndajfolje, si: *qashu, qekështu* e *qeshtu, qekëtu, qaty, qatje, qetash, qaq* nga *qe + aq* etj.

qê-ni ~ qe-ri “dërrasë rrotullare me bisht, ku hollohen petët”, “lopatë me bisht të gjatë, palaré”. Fjalë e mbarë gjuhës me forma të shumta dialektore

e me kuptime të ndryshme: *qer*, *qehën*, *qêh*, *qêth*, *qezë*, *qerth* etj. Forma bazë për të gjitha këto është **qen-*, ku bashkëtingëllorja *-n-* shfaqet në trajtën e shquar të gegërishtes *qeni*, kurse në toskërishte është rotacizuar (*qeri*). Ndryshe nga Çabej, që burimin e fjalës e lidh me fjalën keltike (gal.) **cantos* “rreth i hekurt, anë, qoshe”, sll. kisht. *kotъ*, rus. *kut* “kënd, qoshe”, mendojmë se *qê* përmban një *-n-* të thjeshtë, me të cilën lidhet përbrenda gjuhës me *qye* “shkëmb i lartë me majë të mprehtë”, fjalë me burim të trashëguar nga rrënja ie. **qōn-*, ku bën pjesë gjerm. l. vj. *hnel* “majë, kulm”. Fonetikisht, ndërsa *qê* ka pasur një bazë me *-e-* të shkurtër, që iu nënshtrua hundorësisë, *qye* ka pasur një bazë me *-ō-* (me apofoni kuantitative e kualitative), që ka dhënë togun *-ye-* kur ndiqej nga një *-n* (khs. *arsye* nga lat. *ratiōnem*). Trajta toske *qê-ri* është e atyre të folmeve që e kthejnë zanoren hundore *-ê-* në *-ë-* (khs. *vënd*). Emri *qer* i toskërishtes është formuar prej trajtës së shquar *qeri* me rrugë prapashkuese. Forma *qerth* (Myzeqe) ka marrë prapashtesë deminutive. (Meyer EW 224, Vasmer Wort. 34, La Piana Liq. 25, Çabej SE VI 259, Orel AED 359, Luka IV 19).

qekth m. “shi me pika të turbullta në kohë shtrëngate me erë e me pluhur”. Fjalë e gegërishtes veriore. Formim i brendshëm me prapashtesë deminutive nga një bazë **qek* me burim onomatopeik, si imitim i zhurmës që bëjnë pikat e shiut kur bien. Lidhet përbrenda gjuhës me *çek* e *çik* “prek lehtë”, që janë krijime të sistemit fonoleksikor të shqipes (khs. *cek* ~ *çek* ~ *qek*). Edhe folja *çik*, ashtu si *qek-th*, ka krijuar emrin *çikë* për “pikë shiu, gjerbë”.

qep m. “sqep”, “lëfyty, çep”, “maja e zgjatur dhe e mprehtë e një vegle”, “majth për të gdhendur gurin e mullirit”. Fjalë e mbarë gjuhës me disa kuptime. Lidhet përbrenda gjuhës me foljen *kep* “kalit gurin e mullirit, kosën etj.”, “çukit me sqep”, “quk”, ku grykorja *k-* para qiellzores *-e-* dëshmon se fjala i përket atyre të folmeve që kanë grykore në vend të qiellzores para një zanoreje të tillë; si rrjedhim, *qep* e *kep* janë krijime të sistemit fonoleksikor të shqipes, që ka formuar fjalë me afrikate e qiellzore (*cep* : *çep* : *qep*). Prej *qep* është formuar *sqep* me parashtesë, duke nënkuptuar përsëri një send me majë. Rrjedhoja të tjera janë: emrat *qepel* “maja e kazmës a e çekanit”, *qepar* “gyp i vogël me ujë dhe me një flluskë ajri, me të cilën përcaktohet rrafshi a drejtimi horizontal” (në gjasë të lëfytit), *qepore* “zmalt” (Gazulli); mbiemrat *qepësh* e *qepç* “që ka majë të mprehtë (për veglat)”, folja *qepoj* “shpoj me diçka që është me majë; godit, qëlloj”. (Meyer EW 222, Camaj AW 80, Orel AED 357, Çabej SE VI 262, Luka IV 17).

qérëse f. “tokë e zhveshur; djerr”. Fjalë dialektore. Formim i brendshëm nga emri *qere* “sëmundje ngjitëse e lëkurës së kokës, që shkakton edhe rënien e flokëve”, në këtë rast me kuptimin “(tokë) e zhveshur, pa bimësi”, ashtu siç është njeriu pa flokë me sëmundjen e qeres. Ka marrë

prapashtesën *-(ë)s* dhe formantin *-e* të gjinisë femërore. Një formim tjetër i brendshëm me të njëjtin kuptim është *qestër*, që ka marrë prapashtesën *-tër* (khs. *kostër*, *lëmoshtër*). Në një formë *qer(ë)s-tër* ka rënë njëra lëngëzore me anë të disimilimit në shkallën zero.

që psz. “qysh”. Përdoret për të shënuar pikënisje vendi, kohe etj. (*që këtu*, *që sot e tutje*), si edhe një tërësi të caktuar (*që të dy*, *që të gjithë*). Në këto kuptime e përdor dialekti toskë, ndërsa gegërishtja në vend të saj përdor *qysh*. Lidhet përbrenda gjuhës me *qyetë*, që e kanë autorët e vjetër me kuptimin “aq”; Budi: *të thashë përsipëri se janë ende shtatë të tjera, të shpirtit qyetë sã të Korpit* (DC); Bogdani: *Prej Jovit ndjerë mbë Saturnit janë qyetë*. Ndërsa *qyetë* nga *qye* + *të* ka dalë nga përemri i trashëguar *q^hōn* me zberthimin e rregullt të zanores *-ō-* në *-ye-* para *-n-së*, pjesëza *që* është forma e shkurtër e këtij përemri, që del me zanore të rrëguar për hir të pozicionit të patheksuar në fjali (khs. *mua* / *mue* e *më* nga ie. *mōn*). Kjo pjesëz merr pjesë në formimin e përemrave e ndajfoljeve *aq* < *a* + *që* dhe *kaq* < *kë* + *aq*. Në përngjitje me fjalë të tjera janë formuar: *qëkur*, *qëkurse*, *i qëkurshëm*, *qëlashti*, *qënatje*, *qëparë*, *qëpari*, *qëparthi*, *i qëparshëm*, *qëmenatë* etj. (Meyer EW 217, Meyer-Lübke Gröbers Gr. I² 1904-1906, 1051, Pușcariu EW 245, Topalli Dift. 175).

qëroj fol. “i heq lëkurën”, “pastroj puplat”. Fjalë e mbarë gjuhës, me burim të diskutueshëm. Mund të jetë fjalë e trashëguar që lidhet me rrënjën ie. *ker-* “pres, korr”, ku bëjnë pjesë gr. κείρω “pres, ndaj”, lat. *corium* “lëkurë”, duke u lidhur përbrenda shqipes me foljet *korr* e *kruaj*, të dyja këto në marrëdhënie apofonike: *qëroj* nga *ker-* + *-o* me *-e-* të shkurtër, që e ka kthyer grykoren në qiellzore; *korr* e *kruaj* me *-ē-* (të gjatë), që është kthyer që herët në *-o-* duke e ruajtur grykoren. Në këtë rast kuptimi i hershëm do të ishte “pres, heq lëkurën”. Një burim tjetër mund të jetë emri *qere* “një sëmundje që shkakton rëniën e flokëve”. Në këtë rast, kuptimi më i hershëm del “qëroj puplat, heq pushin (duke e qëruar)”. Një burim i tillë do të përlligjej edhe nga fakti se emri *krosë* “qere, qerosë” lidhet me rrënjën ie. *ker-* “pres, korr”. Fjala dëshmohet së pari te Buzuku: *A do na të vemte t i qërojmë?* Rrjedhoja të fjalës janë: *i qëruar* e *i paqëruar*, *qëruese* (patatesh, mollësh etj.), *qërojsë* “thikë e posaçme për të qëruar perime a pemë”, *qëroke* “qëruese misri”. (Camarda I 44, Mihăescu RĚSEE 1-2, 1966, 15, Haarmann Lat. Lehn. 45, Orel AED 360, Luka IV 26).

qýe f. “majë, bisht”: *qyeja e malit* “bishti i malit”, *mbë qyet të majës* “në majë të majës”, *qyet e shkambit* “maja e shkambit” (Gazulli). Fjalë e gegërishtes, e trashëguar. Lidhet me rrënjën *qōn-* “ngjesh, pickoj”, ku bëjnë pjesë ind. vj. *kanda-* “top, gungë”, gr. κόνδυλος “shkop, grusht”, gjerm. l. vj. *hnel* “majë, kulm”. Prej saj është formuar *qetë* “shkëmb me majë të mprehtë”,

nga trajta e shquar e shumësit. (Walde-Pokorny I 390, Orel AED 364, Topalli Dift. 194).

qysh ndf. “si?, në ç’mënyrë?”. Përdoret edhe si lidhëz, edhe si pjesëz, karakteristike për dialektin gegë, me intensitet përdorimi të ndryshëm sipas krahinave. Duke pasur burim përemëror, *qysh* lidhet përbrenda gjuhës, nga njëra anë, me përemrin pyetës *kush* dhe nga ana tjetër, me përemrin lidhor *që*. Lidhja fonetike me përemrin *kush* është e tillë: të dy përemrat kanë fundore të njëjtë, por ndryshojnë nga njëri-tjetri në zanoren e trupit të fjalës: ndërsa *kush* ka një zanore të prapme, gjë që ka ruajtur karakterin grykor të bashkëtingëllores nistore; *qish* ka një zanore të përparme, e cila e ka shndërruar grykoren në qiellzore. Kurse lidhja me përemrin *që* është e tillë: të dy këta përemra kanë pasur zanore të përparme, *-i-* ose *-e-*, që e ka kthyer grykoren në qiellzore; por ndryshojnë nga njëri-tjetri në mbaresat e tyre. Ndërsa *qish* ka fundoren *-sh*, ashtu si përemri *kush*, duke qenë të dy këta përemra të rasës emërore, përemri *që* paraqet një formë tjetër rasore, mbase rasën kallëzore me mbaresën *-m*, që ka përfunduar në *që* për hir të mbaresës me bashkëtingëllore hundore (khs. *kë*, *kû*), si edhe për hir të pozicionit të patheksuar në fjali. Fjala dëshmohet së pari në Fjalorthin e kalorësit gjerman Arnold von Harff (1497): *kess felgen gyo kaffs* “qish vëljen kjo kafsh(ë) - gjerm. *wat gilt dat ich*”. E ka edhe Buzuku me formën *qish*, që është më e vjetër se *qysh*: *U të endiglonj qish të më thoetë Zotÿnë endë muo*. Ky autor ka edhe *qishdo* e *qishdota* për “çkado, çdo, çfarëdo” e dyta me përemrin asnjanes (*a*)ta. Matrënga ka edhe *gjithëqish* për “çdo gjë, gjithçka”. Nga *qysh* është formuar emri *qyshe* “mënyra si bëhet një punë”, me emërzimin e ndajfoljes, si edhe kompozitat *qyshkur* “prej kohësh”, *qyshmos* e *gjithqysh* “gjithsesi”. (Orel AED 364).

SUMMARY

FROM ETYMOLOGICAL DICTIONARY OF ALBANIAN VI

orték < *o-* + *rrotë* + *-ek* (*-ak*); **oshënar** < *o-* + *shën* + *-ar*; **oshëtín** < *osh* (onomat.) + *-(ë)t-* + *-in* (cf. *vetëtin*, *shkrepëtin*); **palmúc** < *palë* + *muq* (it. *mucchio*); **papërdhók** < *kokërdhok*; **parméndë** < *për-* + Lat. *armamentum*; **páshtër** < Lat. *pastūra*; **(i) pavidrë** < *vdjerr*; **pëqí** < Lat. *clino*; **përbinjóre** < *për-* + *binjore* (cf. *binjak*, *binjok*, *binjarak*, *binjosh* and *binak*, *binok*, *binosh*, *bineq*); **përcëllój** < *për-* + *cull*; **përçollák** “*Euscorpius flavicandis*” < *për-* + *çalle* (cf. *çaj*) + *-ak*; **përdhós** < *pordhë* + *-os* (cf. *vendos*, *fundos*); **përhíhet** < *për-* + *hije*; **përkúnd** < *për-* + **ku(n)t-* (cf. *lëkund* and *shkund*) : IE. **qut-*, Lit. *kutù*, *kutëti*, OHG *scutten*; **përlák** < *pulë* + *-ak*; **përpeq** < *për-* + *pjek*; **përqáll**

< *përqell* (*për-* + *qell*) : IE. *q^hol-*, Lat. *colo-ëre*, Gr. *πέλομαι*, Old Ind. *cáratī*;
përqéth < *për-* + *qeth*; **përshkëndís** / **përshkëndít** < *për-* + *shkëndis* /
shkëndit; **përrúa** / **përrúe** < *për-* + *rēn-*, cf. Got. *rinnan*, *rann*, *runs*, Old Isl.
run, OHG *runs*, *runsa*; **pështëllíj** < *pësht* (onomat.) + *-ët* + *-inj*; **pilivésë**
 ”*Libellula vulgata*” < *pili* + *vesë* (cf. *piliherdhe*, *pilipizgë*, *pilipuç*, *pilivrom*,
pilingrefës); **píngël** < *ping* (onomat., cf. *pingëron*) + *-lë*; **pinók** < *pip* + *-an* + *-*
ok (**pip-an-ok*); **pisërëngë** “*Salamandra maculata*” < *pis* + *rëngë* (onomat.);
pispillósem < *pi-s-pill-os*: *pi-* from *për-* + *-s-* + *pillë* + *-os* (cf. *pilloj*,
spillohem, *pispilluq*); **pishllój** < *pish* (onomat.) + *-(ë)ll-o(j)*, cf. *fishkëlloj*;
pitigónë < It. *pettegola*; **pjekallárthi** < *pjekë* + *-llarë* (cf. *baballarë*,
xhaxhallarë); **pjérez** “*Chenopodium giganteum*” < *pjerdh* + *-zë*; **pjerr** < *prier*
(për- + **er-*); **plándë** < Lat. *planta*; **plandós** < **plandë* (Lat. *planta*) + *-os*;
plánë < Lat. *plānum*; **plapurítëm** < **plap* (onomat.) + *-(ë)r* > *-ur* + *-it* (cf.
çuçurit, *pllaqurit*); **pleng** : IE. **plek-*, Gr. *πλήσσω*, Lit. *plakù*, Old Bulg. *plača*,
plakati; **plim** : IE. *plē-* + *-m*, Lat. *com-plētus*, Old Ir. *līnaim*, Gr. *πίπημι*, Got.
fulls, Old Ind. *purú*; **pllaqurítëm** < *pllaq* (onomat.) + *-(ë)r* > *-ur* + *-it* (cf.
çuçurit, *plapurítëm*); **po** cf. *por*, *pa* (IE.); **por** cf. *për* (IE.); **poshtëj** < *po-* (*për-*)
 + *shtie* + *-o*; **praj** < *për-* + *ajem*; **préhër** / **préhën** : IE. **perk-*, Old Ind.
parçu-h, Av. *parasu-*, Old Bulg. *prəsi*; **prej** < *për* + *e* (*për* > *pr* + *e* > *pre-j*);
prek < *për-* + *rrek* : IE. **rek-*, Latv. *ruoka*, Old Rus. *pyka*; **(e) prémte** <
pramë + *-te*; **pres** ~ **preva** < *preh* (*për-* + *eh*); **pres** ~ **prita** < *për-* + *et-* (*përes*
 ~ *përet*), cf. *jes* ~ *jet* and *mbes* ~ *mbet* (*mbë-* + *-et*); **prier** < *për-* + IE. **er-*,
 Old Ind. *ṛṇóti*, *ṛṇváti*, Av. *arəti*, Arm. *y-arnem*, Gr. *ῥρνυμι*; **prij** < *i parë* (IE.
pr̥mo-, Old Ind. *purvaḥ*, OCS *pr̥vъ*, Lit. *pir̥mas*, Gr. *πρώτος*, Lat. *primus*);
prijë < *prij* (verb); **prik** < *prier* + *-k* (**prier-k* > *prik*); **prish** : IE. *pr̥ts-*, Gr.
πρις-πρίω, **próčkë** < cf. *broçkulla*; **prófkë** < *prof* (onomat.) + *-kë*; **(i) próshkët**
 cf. *boshkë* and *boçkë*: *fik boçko*; **prozhmój** < cf. *proçkë* (**proç-kë*) and
broçkulla (**broç-k-ull-a*); **prúaj** / **prúej** < Lat. *parāre*; **púçërr** < *puç* + *-ërr*;
púfkë < **puf* (onomat.) + *-kë*; **pulisht** < *pulë* + *-isht*; **púpë** cf. *bubë*; **pupurít** <
 pur-pur* (onomat.) + *-it*; (khs. *shushurin* from **shur-shur*); **puq < *puqem* (cf.
pjek); **purój** < *përuaj*, *përoj* from Lat. *parāre*; **pusëtë** < It. *pozzetto*, (cf.
pozzo); **pushtëj** < *pushtet* + *-o*; **pútër** < *putë* + *-(ë)r* : Old Ind. *pad-*, Gr. *πάς*,
πούς ~ *ποδός*, Lat. *pēs* ~ *pēdis*, Got. *fōtus*; **pýkë** < **pilkë* (cf. *pilë*); **qápë** <
çapë (cf. *kërçabë*); **(i) qártë** < It. *chiaro* + *-të*; **qasón** < *qa(j)* + *-so*; **qe** < Lat.
ecce; **që-ni** ~ **qe-ri** (cf. *qer*, *qehën*, *qêh*, *qêth*, *qezë*, *qerth* etc.) < IE. **qen-*,
 OHG *hnel*; **qekth** < **qek* (onomat.) + *-th*; **qep** < *kep*; **qërëse** < *qere* + *-(ë)s*;
që < cf. *qyetë* (IE.); **qëroj** < IE. *ker-*, Gr. *κείρω*, Lat. *corium*; **qýe** : IE. *qōn-*,
 Old Ind. *kanda-*, Gr. *κόνδυλος*, OHG *hnel*; **qysh** cf. *kush* (IE.).